



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK  
KOMISIONI I KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Nr. 306/12 Prot.

Tiranë, 27.01.2025

**V E N D I M**

Nr. 2, dt. 27.01. 2025

**“PËR  
HAPJEN E THIRRJES PËR APLIKIMIN TË PROJEKTEVE KËRKIMORE  
SHKENCORE DHE BOTIMEVE PËR VITIN 2025”**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, neni 46, Statutin dhe Rregulloren UST-së, Rregulloren e komisionit të përhershëm, Komisioni i Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025, për hapjen e thirrjes së radhës, për projekte kërkimore shkencore dhe botime, në përputhje me strategjinë e kërkimit shkencor të UST-së, Komisioni,

**V E N D O S I:**

1. Hapjen e thirrjes për aplikimin të projekteve kërkimore shkencore dhe botimeve për vitin 2025, duke filluar nga data 27.01.2025 deri më 28.02.2025.
2. Ftohet i gjithë personeli akademik i UST-së të aplikojë për projekte kërkimore shkencore dhe botime, duke iu referuar formularit standard të miratuar nga komisioni, i cili është i disponueshëm në faqen zyrtare të UST-së.
3. Aplikimet do të dorëzohen pranë Komisionit nëpërmjet email-it: [ikshs@ust.edu.al](mailto:ikshs@ust.edu.al), si dhe një kopje fizike në formatin hard copy, e cila do të regjistrohet me protokoll. Vetëm aplikimet që dorëzohen në këtë mënyrë do të konsiderohen të vlefshme.
4. Një kopje e këtij Vendimi t’i përcillet Rektorit të UST-së.

5. Një kopje e këtij Vendimi t'i përcillet Administratorit të UST-së.
6. Një kopje e këtij Vendimi t'i përcillet njësive kryesore të UST-së.
7. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore të publikojë këtë njoftim në websitin e UST-së
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof. Asc. Dr. Arben KAÇURRI**

